

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuere, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Njëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë njëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Nëntor, 2021

Hartimi dhe konsultimi i Draft-Raportit të Monitorimit të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën korrik-shtator 2021

15.11.2021. Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, përfundoi procesin e monitorimit dhe hartoi draft-raportin e monitorimit të Planit të Veprimit, 2020- 2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK), për periudhën korrik-shtator 2021. Draft-raporti i monitorimit paraqet në mënyrë analitike dhe sasiore progresin e bërë nga të gjitha institucionet raportuese për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të SNKK, të planifikuara për zbatim për këtë periudhë, nivelin e realizimit të objektivëve strategjikë mbështetur në këtë analizë si edhe ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin e kaluar të monitorimit. Draft-Raporti korrik-shtator 2021, është dërguar për konsultim pranë të gjithë institucioneve zbatuese dhe për publikun dhe grupet e interesuara në faqen zyrtare të ministrisë. Nga vlerësimi paraprak që ofron raporti, vihet re një trend rritës në zbatimin e masave të planifikuara për objektivë me efekt parandalues dhe ndërgjegjësuere. Draft-Raporti do të finalizohet, diskutohet e miratohet në mbledhjen e Komitetit Koordinator për zbatimin e SNKK, që do të mbahet në muajin dhjetor 2021.



Draft-Raporti i Monitorimit Korrik-Shtator, 2021 vijon të jetë i shpallur dhe mund të aksesohet në këtë link: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Draft-Raporti-i-monitorimit-SNKK-Korrik-Shtator-2021.pdf>

Vlerësimi i Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion, pjesë e Manualit të ri për Hartimin e Legjislacionit

22.11.2021. Vlerësimi i Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion (eng. Corruption Proofing of Legislation) është tashmë një praktikë dhe procedurë që do të fillojë të aplikohet edhe në administratën shqiptare, që ka për funksion hartimin dhe rishikimin e ligjeve dhe akteve nënligjore. Si një kërkesë dhe rekomandim në mjaft raporte dhe vlerësime ndërkombëtare, është bërë tashmë pjesë e Manualit të ri (të rishikuar) të Hartimit të Legjislacionit. Ministria e Drejtësisë në cilësinë e institucionit drejtues të hartimit të akteve (hartimi dhe kodifikimit të legjislacionit) ka përfunduar rishikimin e këtij Manuali, ku pjesë e posaçme e tij, Pjesa B/ kreu 7, përmban të detajuar procesin e vlerësimit të hapësirave për korrupsion në legjislacion. Kjo pjesë e Manualit është mbështetur në eksperiencat më të mira operacionale të vendeve që aplikojnë këtë proces vlerësimi. Kjo procedurë është parashikuar të bëhet nga strukturat ligjore pranë ministrive dhe në Ministrinë e Drejtësisë, gjithashtu. Me botimin e tij, Manuali do të publikohet edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

Përfundimi i ciklit të trajnimeve me pikat e kontaktit antikorrupsion

17.11.2021. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian për Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit dhe ASPA, përmbylli gjatë muajit nëntor 2021 ciklin e trajnimeve për pikat e kontaktit antikorrupsion. Përgjatë këtij muaji, u mbajtën dy seanca të tjera trajnimesh, përkatësisht në datat 17 dhe 26 nëntor. Seanca e datës 17 nëntor ishte e fokusuar në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave, ndërsa ajo e datës 26 nëntor ishte e fokusuar në tematikën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Ky cikël trajnimesh është ndjekur nga të gjithë anëtarët e Rrjetit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në institucionet zbatuese të strategjisë dhe planit të veprimit antikorrupsion, me qëllim forcimin e ndërveprimit dhe rritjen e kapaciteteve politike-bërëse dhe raportuese të këtij grupi punonjësish në autoritete të ndryshme publike, në nivel ekzekutiv, të pavarur dhe institucioneve të varësisë. Të gjithë pjesëmarrësit e këtij cikli trajnimesh do të pajisen me një certifikatë për njohuritë e marra të fushës.



Fillon zbatimi i projektit "Kurrikula antikorrupsion në shkollat e mesme"

23.11.2021. Ministri i Drejtësisë, z. Manja, Ministri i Arsimit dhe Sportit, znj. Kushi dhe Ambasadori i Italisë në Shqipëri, z. Bucci, prezantuan Marrëveshjen e bashkëpunimit për krijimin dhe implementimin, në shkollat e mesme shqiptare, të një kurrikule mësimore antikorrupsion me qëllim edukimin mbi ligjshmërinë, në ambientet e shkollës "Qemal Stafa" në prezencë të nxënësve, bashkëpunëtorëve dhe përfituesve të projektit. Marrëveshja do të bëjë të mundur përpunimin e një kurrikule të posaçme për shkollat shqiptare dhe realizimin e një kursi studimi pilot në disa klase të përzgjedhura, në kuadër të një përfshirjeje të qëndrueshme të mundshme të kësaj kurrikule në sistemin arsimor parauniversitar shqiptar. Projekti do të shoqërohet gjithashtu edhe me zhvillimin e aktiviteteve kreative për nxënësit. Viti shkollor 2021-2022, do të shoqërohet me këtë bashkëpunim gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

Aktivitetet e Ministrisë së Drejtësisë në Javën e Integritetit III, 1-10 dhjetor 2021: Forum me Organizatat Rinore dhe Forum me Përfaqësues të Bizneseve

26.11.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, do të organizojë dy forume diskutimi me pjesëmarrës organizata rinore, parashikuar për t'u mbajtur në datë 6 dhjetor dhe me përfaqësues të biznesit, parashikuar për në datë 7 dhjetor. Këto aktivitete do të zhvillohen në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë. Partneriteti dhe afrimi i të rinjve në procesin e hartimit të politikave të fushës antikorrupsion, proaktiviteti dhe rritja e ndërgjegjësimin kundër fenomeneve korruptive janë çështje që do të jenë pjesë e diskutimeve të lira e përfaqësues të organizatave rinore. Biznesi si një urë bashkëpunimi në forcimin e strukturave ndëshkuese dhe kontrolluese në raste korruptive si dhe prezantimi i kapaciteteve të riorganizuara të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion do të jenë çështje të bashkëbisedimit në forumin me përfaqësues të Shoqatave dhe të Dhomave të Bizneseve, që punojnë e funksionojnë në vend. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë do të jetë pjesë e paneleve të takimeve, konferencave dhe aktiviteteve të tjera përgjatë Javës së Integritetit.



Ndërkombëtarizimi dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal antikorrupsion

2-3.11.2021. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit mori pjesë në takimim e Grupit Drejtues të Iniciativës Rajonale Antikorrupsion (eng. RAI) në Zagreb, Kroaci. Grupi Drejtues i RAI, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria, mori në shqyrtim ecurinë e projekteve rajonale antikorrupsion në sektorë të ndryshëm si arsimit, sipërmarrjet publike, bashkëpunimi me OSHC-të, ndërgjegjësimi dhe promovimi i mekanizmeve antikorrupsion. Propozime të reja të bashkëpunimit rajonal antikorrupsion si dhe bashkëpunime me organizata ndërkombëtare si Akademia Ndërkombëtare Antikorrupsion (IACA), Sekretariati i Qeverisjes së Sigurisë së Brendshme të Integruar (IISG), Rrjeti i Agjencive Parandaluese të Korrupsionit (NCPA) dhe Komisioni për Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit në Kroaci ishin pjesë e diskutimeve intensive në takim. Grupi Drejtues i RAI dakordësoi propozimin e sekretariatit teknike për të promovuar në vijim rolin rajonal të organizatës edhe pranë njësive dhe agjencive të Bashkimit Evropian dhe të Komisionit Evropian.

Informacion të mëtejshëm mbi takimin e Grupit Drejtues të RAI mund të gjeni në këtë link: <https://rai-see.org/36th-meeting-of-the-rai-steering-group/>

